



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT
TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 23614 prot.

Tiranë më, 20/12/2019

URDHËR

Nr. 427, datë 20/12 2019


Për

“Miratimin e Programit të Trajnimit të Vijueshëm Profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik për vitin 2020”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenit 20 të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikës 4 të nenit 8 të “Rregullores së trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik”, e miratuar me urdhër nr.3, datë 08.01.2016, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Programit të Trajnimit të Vijueshëm Profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik për vitin 2020, sipas dokumentacionit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në sektorin publik dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.



MINISTËR

Anila Denaj